

**MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Nr. 5994 Prot.
Datë 23.08.2021

**MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË**

Nr. 14699/1 Prot.
Datë 9.9.2021

UDHËZIM
Nr. 14, datë 23.08.2021


**PËR
DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 9, DATË 26.02.2021 "PËR
KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL",**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22. 10. 2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të ligjit nr. 137/2021, "Për buxhetin e vitit 2021", të pikës 4, të VKM nr. 1102, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2021"

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr. 9, datë 26.02.2021 "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural", bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në kreun III, pika 10, zëvendësohet me formulimin:
"10. Për masat e investimeve në rastin e ndërtimeve/rikonstruksioneve duhet të sigurohet leja përkatëse e ndërtimit në varësi të investimit (leje ndërtimi/rikonstruksioni ose miratimi i deklaratës paraprake), sipas legjislacionit në fuqi, para lidhjes së kontratës por jo më vonë se 70 ditë kalendarike nga data e përfundimit të aplikimeve, pra data 24.06.2021. Dorëzimi i këtij dokumenti mund të bëhet edhe pas afatit të përcaktuar, por jo më vonë se 30.09.2021. Aplikantët që dorëzojnë lejet pas afatit 24.06.2021 por jo më vonë se 30.09.2021 do të renditen pas aplikantëve që kanë dorëzuar lejet brenda datës 24.06.2021. Mosdorëzimi i lejes së miratuar brenda datës 30.09.2021 përbën kriter skualifikues."
2. Në Kreun VIII, bëhen ndryshimet si më poshtë:



- a) Masa 8, nëndarja "i", shkronja "j" zëvendësohet me formulimin:
"Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës. Leja e ndërtimit/rikonstruksionit ose miratimi i deklaratës paraprake dorëzohet para lidhjes së kontratës por jo më vonë se 70 ditë kalendarike nga data e përfundimit të aplikimeve pra data 24.06.2021. Dorëzimi i këtij dokumenti mund të bëhet edhe pas afatit të përcaktuar, por jo më vonë se 30.09.2021. Aplikantët që dorëzojnë lejet pas afatit 24.06.2021, por jo me vonë se 30.09.2021 do të renditen pas aplikantëve që kanë dorëzuar lejet brenda datës 24.06.2021."
- b) Masa 8, nëndarja "iii", pika 9 zëvendësohet me formulimin:
"Dokumenti origjinal ose fotokopje e noterizuar e Lejes së ndërtimit/rikonstruksionit ose miratimi i deklaratës paraprake sipas legjislacionit në fuqi. Ky dokument mund të dorëzohet edhe para lidhjes së kontratës brenda 70 ditë kalendarike nga data e përfundimit të aplikimeve pra data 24.06.2021. Dorëzimi i këtij dokumenti mund të bëhet edhe pas afatit të përcaktuar, por jo më vonë se 30.09.2021."
- c) Masa 9, nëndarja "i", shkronja "o" zëvendësohet me formulimin:
"Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës. Leja e ndërtimit/rikonstruksionit ose miratimi i deklaratës paraprake dorëzohet para lidhjes së kontratës por jo më vonë se 70 ditë kalendarike nga data e përfundimit të aplikimeve pra data 24.06.2021. Dorëzimi i këtij dokumenti mund të bëhet edhe pas afatit të përcaktuar, por jo më vonë se 30.09.2021. Aplikantët që dorëzojnë lejet pas afatit 24.06.2021, por jo me vonë se 30.09.2021 do të renditen pas aplikantëve që kanë dorëzuar lejet brenda datës 24.06.2021."
- d) Masa 9, nëndarja "iii", pika 10 zëvendësohet me formulimin:
"Dokumenti origjinal ose fotokopje e noterizuar e Lejes së ndërtimit/rikonstruksionit ose miratimi i deklaratës paraprake sipas legjislacionit në fuqi. Ky dokument mund të dorëzohet edhe para lidhjes së kontratës brenda 70 ditë kalendarike nga data e përfundimit të aplikimeve pra data 24.06.2021. Dorëzimi i këtij dokumenti mund të bëhet edhe pas afatit të përcaktuar, por jo më vonë se 30.09.2021."

3. Në kreun IX, bëhen ndryshimet si më poshtë:

- a) në pikën 3, togfjalëshi "një afat 10 ditë pune", zëvendësohet me formulimin "një afat 15 ditë kalendarike";
- b) Pas pikës 9, në paragrafin e dytë, fjalia "Dorëzimi i dokumentave pjesorë apo përtej afatit të përcaktuar është kriter skualifikimi, me përjashtim të lejes së ndërtimit, e cila duhet të paraqitet para lidhjes së kontratës por jo më vonë se 70 ditë kalendarike nga data e përfundimit të aplikimeve" zëvendësohet me formulimin:



“Dorëzimi i dokumentave përtej afatit të përcaktuar është kriter skualifikimi, me përjashtim të lejes së ndërtimit”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**

MILVA EKONOMI

**Në mungesë dhe me urdhër
ZV/MINISTRI**

ROLAND KRISTO

